

20232634554

LIGJ PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Neni 1

Në Ligjin e Kujdesit Shëndetësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16, 37/16 dhe 20/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 101/19, 153/19, 180/19, 275/19, 77/21, 122/21, 178/21, 150/22, 236/22 dhe 199/23), neni 222 ndryshohet si më poshtë:

“(1) Punëtorët shëndetësorë – specialistë të punësuar në institucionin shëndetësor publik, të cilët kryejnë veprimtari shëndetësore specialistike-konsultative dhe spitalore, me më shumë se dy vjet përvojë pune në specialitet, mund të ofrojnë shërbime shëndetësore si veprimtari shtesë, pas orarit të rregullt të punës dhe në përputhje me licencën e tyre për punë, në institucionin shëndetësor publik ku janë të punësuar ose në institucion tjetër shëndetësor publik ose privat që është i regjistruar për të njëjtën veprimtari, ku shërbimin shëndetësor e ofrojnë në mënyrë të pavarur ose në ekip të udhëhequr nga punëtori shëndetësor-specialist, i përbërë nga punëtorë shëndetësorë dhe punëtorë të tjerë në institucionin shëndetësor në të cilin kryhet veprimtaria plotësuese (bashkëpunëtorë shëndetësorë dhe/ose persona ndihmës-teknikë) të cilët marrin pjesë në veprimtarinë shtesë (në tekstin e mëtejme: ekip për veprimtari shtesë).

(2) Punëtorët shëndetësorë të punësuar në institucionet shëndetësore private në nivel primar të kujdesit shëndetësor me kohë të plotë dhe me më shumë se dy vjet përvojë pune në veprimtari mund të ofrojnë shërbime shëndetësore si veprimtari shtesë, pas orarit të rregullt të punës dhe në përputhje me licencën e tyre të punës, në institucion shëndetësor publik me sigurimin e pandërprerë të ndihmës urgjente mjekësore 24 orëshe dhe në sigurimin e pandërprerë të kryerjes së veprimtarisë shëndetësore me kujdestari.

(3) Për të treguar shërbimet shëndetësore si veprimtari plotësuese, punëtorët shëndetësorë dhe/ose ekipi i veprimtarive plotësuese, drejtuar drejtorit të institucionit shëndetësorë në të cilin janë punësuar parashtrajnë kërkesë me shkrim për pëlqim për kryerjen e veprimtarisë plotësuese, të paktën pesë ditë para kryerjes së veprimtarisë shtesë.

(4) Drejtori i institucionit shëndetësorë në afat prej tre ditësh nga parashtrimi i kërkesës së paragrafit (3) të këtij neni është i detyruar të japë pëlqim për dhënien e shërbimeve shëndetësore si veprimtari shtesë nëse parashtruesi i kërkesës i plotëson kushtet sipas paragrafit (1) të këtij neni dhe në muajin e kaluar i ka plotësuar të gjitha detyrimet e planifikuara në institucionin shëndetësorë në të cilin është punësuar.

(5) Të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella ndërmjet punëtorëve shëndetësorë dhe/ose ekipit për veprimtari shtesë dhe institucioneve shëndetësore në të cilat ata tregojnë shërbimet shëndetësore si veprimtari shtesë nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, rregullohen me marrëveshje për veprimtari shtesë, në të cilin rregullohet në mënyrë të veçantë shuma dhe mënyra e pagesës së kompensimit për punëtorin shëndetësor dhe ekipin për veprimtari shtesë.

(6) Me përjashtim të paragrafëve (3), (4) dhe (5) të këtij neni, në rast emergjence ose në rast nevojë të domosdoshme për ofrimin e shërbimeve të aragrafit (2) të këtij neni, punëtorët shëndetësorë dhe /ose ekipi që ka ofruar shërbimin si veprimtari shtesë për drejtorin e institucionit shëndetësor në të cilin janë të punësuar paraqesin njoftim për shërbimin e ofruar me konfirmim për urgjencën e rastit në të cilin është ofruar shërbimi shëndetësor ose për domosdoshmërinë për shërbimin e ofruar shëndetësor, të lëshuar nga institucioni në të cilin është ofruar shërbimi, ndërsa marrëveshja për veprimtarinë shtesë për shërbime shëndetësore lidhet për çdo rast të veçantë pas shërbimit të treguar.

(7) Marrëveshjen për veprimtari shtesë të paragrafëve (5) dhe (6) të këtij neni, institucioni shëndetësor në të cilin shërbimet shëndetësore janë të shënuara si veprimtari shtesë e dorëzon në afat prej tri ditësh nga lidhja në Ministrinë e Shëndetësisë e cila kryen mbikëqyrje mbi zbatimin e marrëveshjes.

(8) Punëtori shëndetësor - specialist i aragrafit 91) të këtij neni i cili kryen shërbim shëndetësorë si veprimtari shtesë në institucionin shëndetësorë privat me të cilin ka lidhur marrëveshje, është i detyruar më së voni në afat prej shtatë ditësh nga lidhja e marrëveshjes, ta njoftojë drejtorin e institucionit shëndetësorë publik në të cilin është i punësuar për marrëveshjen e lidhur, periudhën për të cilën është lidhur dhe për kohën në të cilën do ta kryejë shërbimin shëndetësorë si veprimtari shtesë.

(9) Institucioni i Shëndetit Publik në të cilin tregohen shërbime shëndetësore si veprimtari shtesë është i detyruar t'i fus shërbimet shëndetësore në sistemin e integruar shëndetësorë informatik.

(10) Listën e çmimeve dhe mënyrën e kryerjes së veprimtarisë shtesë në institucionin shëndetësorë publik në të cilin tregohen shërbime shëndetësore si veprimtari shtesë i përcakton drejtori, përkatësisht drejtorët e institucionit shëndetësorë publik, në përputhje me ministrin e Shëndetësisë.

(11) Listën e çmimeve dhe mënyrën e kryerjes së veprimtarisë shtesë në institucionin shëndetësorë privat në të cilin tregohen shërbime shëndetësore si veprimtari shtesë i përcakton drejtori i institucionit shëndetësorë privat.

(12) Çmimi i shërbimeve shëndetësore të cilat tregohen si veprimtari shtesë në institucionin shëndetësorë publik është i përbërë nga çmimi që e mbulon Fondi, kompensimi të cilin pacienti e paguan si person i siguarur me mjete personale në shërbimet e përgjithshme shëndetësore dhe kompensimi për ekipin për veprimtari shtesë.

(13) Çmimi i shërbimit shëndetësorë që tregohet si veprimtari shtesë në institucionin shëndetësorë publik paguhet në llogari të veçantë (me dedikim) për veprimtari shtesë të institucionit shëndetësorë publik.

(14) Listat e çmimeve nga paragrafët (10) dhe (11) të këtij neni shfaqen në pjesën hyrëse të institucionit shëndetësorë, në vend lehtësisht të dukshëm dhe qasës (tabelë e shpalljeve, sportel, pika pagese) dhe publikohen në ueb faqen e institucionit shëndetësorë.”.

Neni 2

Titulli para nenit 223 dhe 223 ndryshohen si më poshtë:

“Kushtet për kryerjen e veprimtarisë shtesë në institucionin shëndetësorë publik

Neni 223

(1) Punëtori shëndetësor - specialist i punësuar në institucionin shëndetësorë publik, në mënyrë të pavarur ose me ekipin për veprimtari shtesë, ka të drejtë gjatë një muaji, çdo ditë pune pas orarit të rregullt të punës dhe/ose të shtunën dhe të dielën, në veprimtari shtesë:

1) më së shumti deri në 20% nga intervenimet e realizuara të përgjithshme në tre muajt paraprak;

2) më së shumti deri në 20% nga procedurat diagnostike dhe shërbimet specialiste-konsultative të realizuara të përgjithshme në tre muajt paraprak;

3) më së shumti deri në 20% nga shërbimet specialistike-konsultative të kryera të përgjithshme) në tre muajt e mëparshëm, në përputhje me evidencën e shërbimeve të kryera në listën elektronike të ekzaminimeve dhe ndërhyrjeve të planifikuara në sistemin e integruar shëndetësorë informatik.

(2) Punëtori shëndetësor - specialisti i punësuar në institucionin shëndetësor privat me marrëdhënie pune të vendosur me orar të plotë ka të drejtë të formojë ekip për veprimtari shtesë në përputhje me licencën e tij për punë në institucionin shëndetësor publik që është i regjistruar për veprimtarinë e njëjtë, për të cilën në institucionin publik shëndetësor ka mungesë të stafit profesional për kryerjen e vazhdueshme dhe të pandërprerë të pjesës së veprimtarisë në të cilën shërbimi shëndetësor është shënuar si veprimtari shtesë, në të cilin punonjësit ekiporë të institucioneve shëndetësore publike dhe private mund të marrin pjesë.

(3) Drejtori i institucionit shëndetësorë publik është detyruar të bëjë orar për shfrytëzimin e termineve të lira dhe për muajin e ardhshëm t'i publikojë deri në fund të muajit vijues në sistemin e integruar shëndetësorë informatik.

(4) Punëtori shëndetësorë - specialist i cili kryen veprimtari shtesë, me kërkesë të pacientit, është i detyruar ta anulojë terminin e caktuar për shfrytëzimin e shërbimit shëndetësorë në veprimtari shtesë përmes listës elektronike të kontroleve dhe ndërhyrjeve të caktuara.

(5) Shërbimi shëndetësor i shënuar si veprimtari shtesë në institucionin shëndetësor publik është në ngarkesë të Fondit, përveç kompensimit të ekipit për veprimtari shtesë dhe pjesëmarrjes së pacientit si person i siguar me mjete personale në shërbimeve shëndetësore të përgjithshme. Shërbimi shëndetësor i ofruar personave të siguar përmes veprimtarisë shtesë në institucionin shëndetësor privat plotësisht është në ngarkesë të pacientit si person i siguar, i cili nuk ka të drejtë të kërkojë kompensim të shpenzimeve të shërbimit shëndetësor të kryer si veprimtari shtesë në institucion shëndetësor privat nga Fondi.”.

Neni 3

Në nenin 224, paragrafi (2) ndryshon si më poshtë:

“(2) Punëtori shëndetësor i paragrafit (1) të këtij neni, për nevojat e veprimtarisë shtesë të treguar në institucionin publik shëndetësor, është i detyruar të bëjë kërkesa të veçanta për barna, mjete ndihmëse mjekësore dhe materiale shpenzuese dhe është i detyruar t'i referojë pacientët që ai i ka kontrolluar, përkatësisht mbi të cilët ka kryer ndërhyrje në nivelin dytësor dhe terciar të kujdesit shëndetësor si veprimtari shtesë për shërbime shtesë specialistike-konsultative nëpërmjet listës elektronike të ekzaminimeve dhe ndërhyrjeve të planifikuara me qëllim diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe lëndimeve dhe rehabilitim, për të cilat lëshon udhëzim të veçantë ndërspecialistik, udhëzim specialist-subspecialist, udhëzim për radiodiagnostikë dhe udhëzim për shërbime laboratorike, i cili përmban shenjën "veprimtari shtesë".

Neni 4

Në nenin 312, paragrafi (13) ndryshon si më poshtë:

“(13) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet përgjegjësit në personin juridik nëse nuk vepron në përputhje me nenin 222, paragrafi (4) të këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.